



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE NXITJES SË KONCESIONEVE**

Tiranë, më 28.05.2025

Lënda: Dhënie informacioni mbi të dhënat e kërkuara.

Znj. Erisa Kryeziu

Rruga "Sami Frashëri", Pallati 24, Apartamenti 13, Tiranë.

Në cilësinë e kërkueses është depozituar prej jush pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në mënyrë elektronike, mbështetur në nenin 11 të Ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, kërkesa për informim më datë 03.04.2025. Kjo kërkesë është kaluar për trajtim pranë ATRAKO-s, pas vlerësimit të Koordinatorit për të Drejtën për Informim të këtij institucioni, regjistruar nga ne me numër rendor 01, datë 26.05.2025, në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2025.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj lidhur me vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, konkretisht të: "1. *Listës së të gjitha lejeve të HEC-eve që janë dhënë në Shqipëri në 15 vitet e fundit, prej janarit 2010 deri në mars 2025, duke specifikuar numrin për secilin vit (sa leje janë dhënë), emërtimin e HEC-eve për secilin vit dhe madhësinë e tyre, si dhe 2. Sa prej lejeve të dhëna për ndërtimin e HEC-eve janë çuar deri në fund dhe sa prej tyre nuk janë ndërtuar? Cilat janë arsyet e mos përfundimit të këtyre veprave?*", mund t'ju sqarojmë si në vijim se:

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, asiston Autoritetet Kontraktuese për procedurat e dhënies me koncesion/partneritet publik privat. ATRAKO gjithashtu, mbështetur në VKM-në nr. 285, datë 10.04.2020 "Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)", si dhe në pikën 2 dhe 3 të VKM-së nr. 211, datë 16.03.2026 "Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesionit/Partneritetit publik privat", administron dhe mirëmban Regjistrin Elektronik të Koncesioneve/PPP-ve, duke qënë të përhira në të të dhëna për kontratat koncesionare, përfshirë këtu dhe ato në fushën e hidrocentraleve (HEC). Kështu për informacione të këtij lloji janë Autoritetet Kontraktuese përgjegjëse për menaxhimin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP, ruajtjen e administrimin e dokumenteve përkatëse dhe rrjedhimisht kanë edhe informacionin që kërkohet nga ana juaj. Mbi

këtë lutemi ti drejtoheni pikërisht autoritetit përgjegjës mbi procedurat koncesionare në fjalë, që sipas VKM-së nr. 111, datë 02.03.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, i ndryshuar, është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë. Për sa i përket lejeve të ndërtimit të hidrocentraleve kjo nuk është në fushën e përgjegjësisë së ATRAKO-s dhe nuk disponojmë informacionin e kërkuar.

Me respekt,

Koordinator për të drejtën për informim
Ankiola Gjyli